REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 852/20
Datë/Datum. 23.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: : NP "TERMOKOS" Sh.a

Nr.1 i prokurimit	TER-020-025-2.2.1

Sa i përket tenderit për: Shërbimet e Sigurimit Shëndetësor për Stafin e NP "TERMOKOS" Sh.a

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

KOMPANIA E SIGURIMEVE PRISIG SH.A.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Eduard Lir Ob-2,Lagja Arbëria
(Adresa)

Prishtinë — ***10000***
(Vendi) — ***(Kodi postar)***

038-221-000 — ***(Numri i Faks-it)***
(Numri Telefonit)

Besarb Blakaj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@prisig-ks.com
(Adresa elektronike)

20.10.2020

(Data e parashtrimit të kërkesës) — ***(Nënshkrimi dhe vula)***

Kompania e Sigurimeve PRISIG Shoqëri Aksionare • DREJTORIA •

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

_____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 27.07.2020 Data e hapjes së ofertave: 18.08.2020 Letra standarde për tenderues të pasuksesshëm: 25.08.2020 Kërkesa për rishqyrtim me dt:15.10.2020 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 16.10.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

7. **Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 56 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 61 i LPP-së
Rregullorja për çmime jo-normalisht të ulëta
Vendimi i OSHP-së nr.625/20 i dt.06.10.2020.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. **Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne me dt. 25.08.2020 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku e kanë rekomanduar për kontratë SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A, ndërsa neve na kanë shpallur si tenderues të eliminuar, me arsyetimin se: *"Oferta juaj është me çmim jo-normalisht të ulët.; Nuk keni ofruar dëshmi se posedoni kartela shëndetësore e cila ka qenë kriter në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit".*

Ju sqarojmë se arsyet e AK-së për eliminimin tonë janë të pa bazuar për arsyet si në vijim:

Në lidhje me arsyen e AK-së ku e ka cekur se oferta jonë është më çmim jo-normalisht të ulët, ju sqarojmë se ky pretendim i AK-së është i pa bazuar pasi që, në bazë të dispozitave të nenit 61 të LPP-së për tenderët jo-normalisht të ulët, AK-ja është dashur të kërkoj sqarime shtesë në lidhje me çmimin e ofruar nga ne, mirëpo nuk i kanë respektuar fare dispozitat e lartpërmendura duke na diskriminuar neve si OE i cili i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 4 tek Rregullat për çmime jo-normalisht të ulëta, pasi që nuk e ka zbatuar procedurën e shqyrtimit (inter partes), në të cilin nen parashihet shumë qartë që edhe kur një tender konsiderohet me çmim jo-normalisht të ulët duhet të zhvillohet procedura inter partes dhe nuk mund të eliminohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që e kanë shkaktuar tenderin veçanërisht të ulët.

E faktin se ne nuk jemi OE me çmim jo-normalisht të ulët e ka vërtetuar edhe vetë AK-ja në njoftimin mbi vendimin e AK-së të dt. 25.08.2020, ku na ka eliminuar me arsyen se nuk kemi ofruar dëshmi për kartela mirëpo nuk e ka cekur fare çmimin jo-normalisht të ulët siç ka pretenduar tani AK-ja. Andaj duke u bazuar në faktet e lartpërmendura dhe veprimet e AK-së po krijohet përshtypja se AK-ja qëllimisht nuk dëshiron të na rekomandoj për kontratë.

Gjithashtu arsyeja tjetër për eliminimin tonë nuk qëndron për faktin se ne e kemi sqaruar shumë qartë edhe në kërkesën për rishqyrtim të dt.27.08.2020, ku e kemi cekur si në vijim: "Ne jemi eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit për një kërkesë e cila nuk ka qenë e përcaktuar në dosje të tenderit, pasi që tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1&9.2 kërkesë ka qenë "*Pajisja me Kartela shëndetësore për shfrytëzim ne rrjete te klinikave*", ndërsa si dëshmi është kërkuar "*Dëshmi se kompania ofron kartela për klinika qe bashkëpunon.*
Ne e plotësojmë në tërësi këtë kërkesë pasi që si dëshmi e kemi ofruar Deklaratën për kartela të cilën po ju bashkangjesim edhe një herë.

DEKLARATË PËR KARTELA

Në bazë të së cilës deklarojmë se çdo klient që ka sigurim shëndetësorë tek KS "PRISIG" SH.A do të pajiset me kartel digjitale në Web-faqen tone. Tash e tutje secili klient duhet të jetë i regjistruar ne platformën tonë për tu pajisur me kartel digjitale, çdo institucion si Spitalet apo Laboratorët me të cilët kemi marrëveshje do të mund të shohin pasqyrën e klientit (përfitimet) vetëm me nr. personal apo me nr. të policës.
Shërbimet për raste hospitalizimi dhe jo hospitalizim do të realizohen konform kontratës me AK: NP"TERMOKOS"Sh.a dhe Listës se Klinikave, duke përdorur kartelat digjitale me të cilat do te pajisen të gjithë të siguruarit sipas listës së AK: NP"TERMOKOS"Sh.a.

Autoriteti Kontraktues: NP"TERMOKOS"Sh.a
Titulli i tenderit: Shërbimet e Sigurimit Shëndetësor për Stafin e NP"TERMOKOS"Sh.a
Nr.prokurimit: TER-020-025-2.2.1

Kjo deklaratë është dëshmi e qartë se ne e përmbushim kërkesën e lartpërmendur dhe se arsyeja e AK-së për eliminimin tonë nuk është në përputhje me kërkesën e FDT-së pasi që ne kërkesën e lartcekur si dëshmi dokumentare nuk është kërkuar që të prezantojmë si dëshmi kartela shëndetësore, mirëpo është kërkuar që të prezantojmë dëshmi se i ofrojmë kartelat shëndetësore. Pra AK-ja nuk e ka cekur se çfarë dëshmie duhet të ofrohet, prandaj përderisa nuk e ka cekur decidivisht se çfarë dëshmie duhet të ofrohet atëherë edhe deklarata jonë është dëshmi e qartë dhe konfirmim se ofrojmë kartela por **kartela digjitale**. Pra dëshmia e ofruar nga ne është në përputhje të plotë me kërkesën e FDT-së. Nga ky sqarim kuptohet se ne kemi një sistem më të avancuar duke poseduar me kartela digjitale.

Andaj arsyeja e AK-së për eliminimin tonë është në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP ku shkruan qartë se "*56.3 Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*"
Pra ne jemi eliminuar për një arsye dhe kërkesë e cila nuk ka qenë e parashikuar në dosje të tenderit, prandaj veprimi i AK-së bie në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së.

Nëse AK-ja ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me kërkesën e lartpërmendur dhe deklaratën tonë atëherë ka mundur që në bazë të dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë nga ne dhe jo automatikisht të na eliminoj.

E këtë pretendim tonin e ka vërtetuar edhe vendimi i panelit shqyrtues të OSHP-së me nr.**625/20, i dt.06.10.2020** në të cilin është cekur shumë qartë se *"Duke u bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit dhe dëshminë e kërkuar, AK-ja nuk ka qenë e qartë se çfarë dëshmie apo dokumenti ka kërkuar si dëshmi për kërkesën e lartpërmendur. Paneli shqyrtues vlerëson se AK-ja, gjatë vlerësimit të ofertave mbi bazën e asaj deklarate është dashur ta verifikojë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së edhe për faktin se kjo kërkesë është vendosur sipas nenit 69 të LPP-së. Paneli shqyrtues vlerëson se për tu konsideruar se OE ankues e ka plotësuar kërkesën, AK-ja duhet të bëj me shumë verifikime sipas sqarimit të dhënë më lartë".*
Andaj duke u bazuar në faktet e lartpërmendura shihet qartë se AK-ja, nuk e ka respektuar vendimin e lartcekur të OSHP-së, pasi që nuk ka kërkuar sqarime shtesë në lidhje me deklaratën e ofruar nga ana jonë, edhe pse ka qenë e qartë se ne e plotësojmë këtë kërkesë dhe është kundërligjore të eliminohemi nga ky aktivitet i prokurimit pasi që ne jemi eliminuar për një kërkesë e cila nuk ka qenë e përcaktuar në dosje të tenderit në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së ashtu siç e kemi cekur me lartë.

Ne me dt. 16.10.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore në pretendimet tona ankimore.

AK-ja në arsyetimin e saj vetëm e ka përshkruar arsyen e eliminimit mirëpo nuk ka dhënë ndonjë përgjigje konkrete në pretendimet tona ankimore, fakt ky që tregon qartë se pretendimet tona ankimore janë të bazuara. Ndërsa njëri prej pretendimeve tona e ka vërtetuar edhe vetë AK-ja se nuk qëndron arsyeja për eliminimin tonë duke thënë se ka ndodhur një lëshim teknik nga ana e AK-së dhe është vendosur edhe arsyeja tjetër e eliminimit, andaj ky fakt e tregon qartë jo seriozitetin e autoritetit kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se arsyetimi i AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është komplet i pa bazuar dhe nuk qëndron.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartpërmendura shihet qartë se ne jemi diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit pasi që edhe pse i përmbushim të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë dhe gjithashtu jemi OE më i lirë se OE i rekomanduar për kontratë për **18,630.00 €** dhe jemi më të lirë se të gjithë OE tjerë ofertues.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihet qartë se qëllimi i AK-së është që ne mos të shpallemi fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, sepse janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Prandaj me këtë veprim po rrezikohet të dëmtohet buxheti në vlerë prej **18,630.00 €** pa ndonjë arsye konkrete.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e **OE "KOMPANIA E SIGURIMEVE PRISIG SH.A"** si e bazuar,
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*